



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:252706

Datë: 18.11.2024

Numri i dokumentit: 06467805

C.nr. 1171/2014

GJYKATA THEMELORE NË P.2. - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Egzon Mujaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.p.k “E.G.”, me seli në P., kundër të paditurit A.K., nga P.2., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia me numër C.nr. 1171/2014, e datës 23.04.2014, e paditëses Sh.p.k “E.G.”, me seli në P., kundër të paditurit A.K., nga P.2., për kompensim dëmi.

A r s y e t i m

Paditësja Sh.p.k “E.G.”, me seli në P., me datë 23.04.2014, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurit A.K., nga P.2., për kompensim dëmi.

Gjykata në seancën e shqyrtimit përgatitor të mbajtur me datë 12.11.2024, ka konstatuar se pala paditëse, për këtë seancë është ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore, në seancë nuk ka prezantuar dhe mosprezencën nuk e ka arsyetuar. Ndërsa i padituri nuk ka kërkuar që seanca të mbahet në mungesë të palës paditëse por ka kërkuar që të konsiderohet e tërhequr padia e paditëses.

Meqenëse pala paditëse edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore në seancë nuk ka prezantuar, Gjykata në bazë të nenit 409 par.1 të LPK-së, ka marr aktvendim me të cilin e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses kundër të paditurit dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË P.2. - Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1171/2014, datë 18.11.2024

Gjyqtari
Egzon Mujaj

UDHËZIMI JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimet të njëjtit, Gjykatës së Apelit në P.2., nëpërmjet kësaj gjykate.